

2. Abotyl Kojanani  
mërues

VITI i III — PRILL 1931 — Nr. 2.

# NORMALISTI

Jo në dijën, por në  
vullnetin e fortë  
qëndron vlera  
e njeriut.

HERBART.

**Drejtimi:**  
**E përkohëshmjja "NORMALISTI,"**  
**Shkolla Normale**  
**Elbasan.**

Shtypshkronja "SADE", Elbasan  
1931

## M b r e n d i j a

Ndryshimi ndërmjet mësimi të vjetër e modern.	Faqe 1
Edukata morale.	" 3
Provë mësimi: Gjuhë për rendin e I.	" 5
Provë mësimi: vizatim paraf. e punë dore për rendin e II.	" 7
Provë mësimi: Gramatikë për rendin c III.	" 9
Të rijs dhe qytetnimi.	" 11
Puno në rini, qi të jesh i lumtun në pleqni.	" 14
Vjersha për 'shkolla.	" 15
Një dashuri që humb.	" 16
Folklore-a : a) Kënga e Gjolekës.	" 22
b) Këngë dashurie.	" 22
c) Fjalë të vjetra.	" 23
Për t' u-çlodhur.	" 23
Lajme të Shkollës.	" 24
Problemë.	

### E përkohëshmjë " N O R M A L I S T I , DEL NJI HERË NË MUEJ.

#### E botojnë nxânësit e Normales.

Editor: R. Hoxha '31. ndihmës St. Spasse '32.  
Sekretar: D. Cara '31. " " I. Shishmani '32.  
Arkëtar: T. Gusho '31. " " H. Rami '33.

**P a j t i m i :** për gjashtë numra 2 Fr. ari  
Nji numër kushton 2 Lekë.

## Ndryshimi ndërmjet të mësimit të vjetër e modern dhe rëndësia e dobia e këtij të fundit

Në qoftë se do të krahasojmë një herë mësimin e kohëve të kalueme, gjurmat e të cilit i kemi ende të kthjellta në vehten t' onë, me atë të sotëshmin, për një herë do të na dalin përpara dy drejtime të përkundërta : **Aktiviteti** e **pasiviteti** i fëmijes, dy gjana fare të përkundërta e me një rëndësi tepër të madhe.

Në kohët e përparëshme vetveprimi i nxënësit, që theksohet tepër në pedagogjin e sotëshme, ishte lánun fare më një anë, mbassi mësuesi e quente si shenjë dobësie për 'te që lánun e mësimit të përpunohej bashkë me nxënësit; vetëm atëhere ndihej zani i fëmijes në rend, kur i vinte radha për të thánë atë, që kishte nxënë përmendësh në shtëpi; kështu që báhej mësimi fare i mërzitshëm e monoton. Gjithë kohën e mësimit e shkonte fëmija i shkretë në një heshtje të plotë e tue shikue mësuesin në sy, jo pse, e interesonte mësimi, por pse detyrohej.

Mësuesi i asaj kohe e quente se kishte përpara njerës të pjekun e harronte se ka të bëjë me fëmijë; për këtë arsye pra edhe mësimi ipej fare drejt për së drejti, pa u-kujdesun që lánun e mësimit të krijonte një pikë-mbështetje në jetën e mbrendëshme të fëmijes e shumë herë ishte edhe e fillë, që nuk i përshtatej as fuqis mendore të 'tyne, e pra e pakuptueshme e jo tërheqëse për 'ta.

Qëllimi më i parë i mësimit t' atëhershëm ishte të mbushnit e mendjes së nxënësit me një grumbull njohnesh të gjithëfarëshme, pa u-verejtun aspak se ku po mbillej ajo **farë** e ç' farë cilësie kishte; pra studimi psikik i fëmijes ose më mirë me thánë natyra e 'tij ishte lánun fare mbas dore.

Po të vimë në mënyrën e të mësimit të kohës së tashme, do të shofim se ndryshon puna fund e mëj.

Sot mësuesi áshpërgjithnisht vetëm një udhëheqës në mësime ose, më mirë me thánë, një shoshitës i parafytyrimevet, që pushtojnë shpirtin e fëmijes, e me kohë këto parafytyrime shtohen, shtjellohen e kaliten më mirë ke ata. Áshpë një mëkatë shumë e madhe me e lánun më një anë, atë që një nxënësi; pran-

daj detyra e mësuesit sot është vetëm të nxitunit e gjykimit të tyre për të dallue të qenësishmen nga e paqenësishmja e të shtymit gjithënjë qi të vetveprojnë, sepse kështu do të munde-mi me krijue njerës me mendim të lirë e të pavarua e jo t'atillë, qi të tërhiqen prej rrymës së mendimevet të të tjerëvet. Vetveprimi është ai, qi sjell përfundime të shkëlqyeshme në jetën e njeriut e fërthorazi n'ate të kombevet.

Për t'ia mbrijtë këtij qëllimi si duhet, lypset një punë e plotë e e ndërgegjeshme nga ana e mësuesit, përse vetveprimi është rrjedhja e mësimit, qi përmban me të vërtetë një lëndë të zgjedhun, të përshtatëshme, e të kuptueshme e në këte mënyrë bëhet puna interesante e përmbàhet vemendja e fëmisë në formë t'interesit, mbassi ai nuk është i zoti qi ta fusi në punë vullnetin në të përmbajtunit e 'saj. Sa më shumë interes të ketë mësimi aq më tepër nxitet vetveprimi e munt të themi përgjithnisht se interesi e vetveprimi gjinden në një përpjesëtim të drejtë. Them i përgjithnisht, mbassi ka edhe disa lëndë si Historia e kallzimet, të cilat i ndjekin nxënësit me gjithë qejf pa ndërhymë mësuesi, veçse aty këtu për të dhënë ndonji gjykim për ngjarjen, që po iu tregohet; këtu nuk futet në punë vetveprimi i nxënësit, mbassi duhet qi kto lëndë të lënë një mbresë si një gjë e tanë.

Ajo qi bie në sy më fort në Shkollat e sotshme, është të nxënunit e lirë në formë të njëj bisedimi të rregulltë për pa u tërhequn aspak nxënësit prej librit. Tash deri në fund të vjetit të katërt shkolluer, nxënësit nuk kopiojnë asnji mësime për ta nxënë në shtëpi, e për t'u-ngulitë ke ta më mirë gjanat kryesore të mësimit të jetës, rreth të cilit thuren gjithë lëndët e tjera, bëhen diktime e hartime të shkurtna, qi përmbledhin thelbin e mësimit të jetës ose të historis e të gjeografis në rendin e tretë e të katërt.

Nga sa thamë kuptohet vetvetiu se sot, në periudhën e ulët të shkollës, nuk u epet ndonji orar nxënësve e këte e ka vetëm mësuesi i rendit para sysh.

Një dallim t'jetër me rëndësi i shkollës moderne është edhe mësimi intuitif, e për këte arsye vendi i lindjes trajton sot pikën e koncentrasionit të të gjithë mësimevet të tjera.

Intuita është shpirti i çdo dije të sigurtë. Vetëm ate gjë dimë me siguri, të cilën e kemi fitue me ndihmën e intuites. Idetë pa intuitë, sa do të shumta me qenë, janë të vdekme; pran-daj sot i është dhënë shumë rëndësi mësimit intuitif, aq sa çdo

mësim varet krye-këput prej 'saj; e atje, ku mungon gjâja vetë, iu nepet nxânësvet një intuitë e plotë mendore me anë të njëj shpjegimi të qartë prej mësuësit; kështu qi shpirti i nxânësit mbushet me njohni të njimendëta e jo me fytyra të gabueshme.

Veç këtyne ka një ndryshim të madh edhe në mënyrën e e të mbajtunit të disiplinës.

Mësuesi i mâ-parshëm e kishte për turp me qenë i dashun, fytyrë çelët e i durueshëm me nxânësit, e prandaj ai sillej tepër i rreptë me 'ta. Në vend qi tash, porsa të hÿjmë në kufijt e njëj shkollë, ku janë zhdukun gjurmat e vjetra, me një herë na bie në vesht me plot gëzim fjala " Z. Mësues, „ e kur t' afro-hemi edhe mâ tepër do të shofim se ndërmjet të fëmijvet të vegjël gjindet edhe një i madh me trup, por nga mënyra e të pruemit munt të krahasohet me ata. Ky është mësuesi, i cili dë-shiron të gëzohet e të idhnohet për të mirat e për të këqiat e 'tyne, gjâ me rëndësi kryesore, përse vetëm në këte mënyrë munt t' i hyjë ai në shpirt nxânësit e, kur të ketë mbririmë në këte shkallë, do të munda fare lehtë të gjëjë edhe çelsat, qi do t' i duhen në kohën e mësimi për të hapë dyert e mendjes së 'tyne.

Dashunia e mësuësit është ushqim për zemrat e njoma të fëmijvet edhe bari mâ shërimtar për pësimet e 'tyne. Porse edhe kjo duhet të ketë kufijt e vet e nuk duhet të teprohet në mënyrë qi të rrëxojë vlerën e 'tij para nxânësvet. Medje nga një herë kur çënohet disiplina e nevojshme lypsen me u-përdorë edhe ndeshkimet.

Prej gjithë këtyne ndryshimeve kuptohet puna e randë e edukatorit të sotshëm si edhe dobia e randësia e mësimi modern, kështu qi tash fëmia edhe kur të rritet s' ka pse e kujton shkollën, librat e mësuësin me mëni e me urejtje, por për-kundrazi ndien një kënaqësi të pashoqe.

Sh. Islami '31.

## Edukata morale.

Sa mâ fort vjen e ashprohet jeta, aq mâ fort shifet nevoja qi njeriu të dali në jetën praktike i pajisun me cilësi të mira mendore e shpirtnore. Në qoftë se shkolla përpigjet me i dhënë fëmijës vetëm njohni, pa i zhvilluem fuqit mendore e shpirtnore,

atëherë ajo do t' i kundërshtonte qëllimit më të naltë t' edukatës. Para të gjithave shkolla duhet të formojë njerës me moral. Asht e ditun mandej se mësimi do të jetë njani prej atyne mjeteve, qi duhen për me ia mërrimë këtij qëllimi kaqë të naltë. Por sa janë asi njerëzish, qi e njofin të mirën e me gjithë atë s' e bëjnë! Sa janë prap asi njerëzish, qi nuk kanë aqë vullnet për me u bëmë ball rrymave të kësaj jete, ngadhnimi i të cilave më vonë do t' u sigurojë një herë e përgjithmonë fito:en kundra instinkteve të poshtme e pjerrjeve të këqija!

Edukatori do t' u mësojë dishepujve të 'tij me dashë me fuqi të madhe, me pasë vullnet të fortë; ai duhet të bëjë prej sijsht njerës t' aftë për me gjykue mbas vlerës së vërtetë shkakut, qi munden me i shtymë në punë e me bëmë vendime energjike për punë e vepra të mira. Më fort se t' i edukojë, ai duhet t' i nxisi qi t' edukohen ata vetë, pa pasë nevojë të shtyhen prej ndokujt; pra ai do të formojë njerës me karakter. Porse nuk mund t' i themi një njeriu se ka karakter, vetëm pse mund të ketë vendosun për me bënë ndonji punë ase për me bënë kë ndonji ves të keq; çdo vendim ose inisiativë, për një punë, duhet fillue e ushtrue pak nga pak, deri sa t' i bëhet njeriut shprehë (zakon); e ai qi nuk do ta ketë bënë si shprehë për të veprue mirë, ai pra qi nuk i bëhet gati furtunave të kësaj jete, është i dënuem të bjerë poshtë heret a vonë.

Shprehëja e shtyn njerin të veprojë pa u mundue shumë edhe ushtron një fuqi shumë të madhe në fëmëni, ashtu edhe në moshë të madhe. Ajo na ndihmon në të mbushunit e punimeve trupore pa u mundue edhe pa ndonji lodhje, ashtu edhe në shumicën e punimeve mendore. Në praktikimin e moralit shprehëja ka një rëndësi të jashtzakonshme. Kjo është një nga mjetet më të fuqishëm e më pemëprumës t' edukatës. Ai njeri, të cilit qysh në fëmëni ia kanë ngulë në shpirt shprehëin me parapëlqye interesin e përgjithshëm para sugjestionet t' egoizmit, e bënë të mirën pa mundim, medje pa pasë vetëdijë të shkakut qi e shtyn të veprojë. Ai vuen prej çdo padrejtësiqe qi i bëhet interesit të përgjithshëm, sikurse ta pësonte ai vetë. Ky është shkakut qi psikologu, Gustave le Bon, e përkufizon edukatën tue thënë se: " **Arti i t' edukuemit qëndron në punën për me bënë me kalie e vetëdijëshmjia në të pa-vetëdijëshmen** ". Me këtë na mundëmi me kuptue fare mirë se sa fuqi ka shprehëja në

punën e edukatës. Edukatori pra duhet të dijë efektet e mira edhe rrolin e math qi luen shprehija në vullnetin t' onë. Shprehija len prej të përsëritunit po t' atyne punëve ose prej të zgjatunit po t' atyne mbresave. Me anë t' ushtrimit mund të fitojmë çdo shkathtsi trupore a shpirtnore. Pra për fitimin e këtyne duhet gjithënji t' i përsrisim a t' i ushtrojmë po ato punë deri sa këto të bëhen shprehi. Kemi shprehi mekanike si të sjellunit mirë në shoqni, të ndejtunit e t' ecunit mirë, të mbajtunit e pastërtis. Mandej kemi shprehi morale, sikurse bindja, drejtsija, përpiknija etj, ose mendore, si ajo e vëmendjes, e të vërejtunit me kujdes, e studimit, e gjykimit e tj. I pëjisun kurdoherë prej ndiesinave më të mira të mirësis e të drejtësis, drejtues jo vetëm i mendjes, por edhe i shpirtit, edukatori duhet të formojë personalitete morale, njerës të lirë e të pavarun, të mësuem me ndjekë kurdoherë atë rrugë, të cilën ua cakton ndërgjegjësja e t' atyne e pastër. Ky është pra qëllimi i vërtetë i edukatës morale.

J. Çekaj '32.

## Provë-mësimi

### Dhanun në rendin e I<sup>rë</sup> të shkollës Ushtrimore të Normales.

Landa : Gjuhë.

Thema : Shkrim fjalish. ( të marruna nga  
mësim' i jetës, " të ndrequnit  
e njëj shtëpije karabiná „)

Mësimi u-fillue me një hyrje të shkurtën në këtë mënyrë :

Ju folët shumë gjana për të bënë e njëj shtëpije; pra kush do të më kallëxojë mue bukur se kush na e ndërton shtëpin ? Nxansit u-përgjegjëni : " Shtëpin na e ndërton mjeshtri „ ( do e mos tue i nxitë edhe mësuesi vetë, qi t' i printe në fjalin e duhun e në të thanmen bukur të 'saj, përta i përshatash fuqis mendore të nxânësuet ).

Këtë fjali e thanë katër a pesë nxânës veç e veç e pastaj të gjithë bashkë. Si u-ndërtue e u-kuptue fjalia mir' e bukur prej nxânësuet, u-pyetën se kush është gjaja ( fjala ) më e parë këtu ? Nxânësit u-përgjegjëni " shtëpin; „ këtë fjali e thanë tre a katër nxânës veç e veç e pastaj të gjithë horas. Mbasandaj u-pyetën se sa gjana ( germa ) ndëgjojmë ne këtu ? Nxansit

u-përgjegjën : **sh, t, ë, p, i, n.** ( Këto gërma nuk i tha vetëm një nxânës, por gjithsecili nga një; sepse, tue veprue në këtë mënyrë, mbahet vemendja e nxânësvet mâ mirë në mësim, e gjithsecili ndër 'ta rri gati, qi të përgjigjet. ) Si i numruen nxânësit gërmat një, nga një, u-urdhënuen, qi të nxirnin fletoret e shkrimit mbi bankë, me numrin **1, 2, 3** edhe, si u-këqyrën të gjithë pa le i kishin kalemata a jo, iu tha qi ta shkruenin këtë fjalë tue i porositë qi, kur ta kishte mbarue mësuesi së shkruemi në drrasën e zezë, ta kishin mbarue edhe ata. Si e shkruen u tha qi të lishin kalemata mbi bankë e të shikojshin nga mësuesi. Tue bâmë kështu, u-nxuer edhe fjala "**na**," të cilën, mbassi nuk ishte nevojë ta ndanin në gërma, sepse ishte e lehtë, iu tha qi ta shkruiejshin; bashkë me 'ta e shkruente edhe mësuesi në drrasën e zezë. Në këte mënyrë u-nxuerrën edhe fjalët e tjera, e ato mâ të lehtëta u-shkruen pa u-ndamë në germa, kurse ato mâ të vështirat u-ndanë edhe në rrokje. Si p. sh fjalën "**ndërton**," e thanë dy a tre nxânës veç e veç e pastaj të gjithë horas; mandej e ndanë në rrokje e në gërma tue thanë : **ndër-ton** : goja hapet dy herë, ne ndëgjojmë **n, d, ë, r, t, o, n** ( tue i ndihmue aty këtu edhe mësuesi vetë. ) Si u-mbarue së shkruemi fjalija e parë, i vuni mësuesi një pikë, të cilën e nxuerrën vetë nxânësit tue u-nxitë prej 'tij.

Kështu u-bâ edhe për dy fjalit e tjera. Mâ në fund u-caktue një nga nxânësit, qi të këndonte fjalit, qi ishin shkruet në drrasën e zezë prej mësuesit edhe të tjerët u-porositën qi të ndreqshin gabimet, qi kishin bâ aty, këtu nëpër radhojt e 'tyne, tue i ndjekë vijat e shkrueme me gishtin e dorës së djathtë.

Mâ në fund fare u-urdënuen qi të këndoishin të gjithë së bashku ato, qi ishin shkruet në drrasën e zezë edhe mësuesi me një vijore në dorë përshkonte fjalët e shkrueme në 'te.

**Shënim** : 1) Me qenë se gërmat e mbdhaja, qi i prijnë çdo fjalije nuk ishin nxânë edhe prej nxânësvet, fjalit u-shkruen me ato të voglat.

**Shënim** : 2) Ky mësim u-zhëvillue për një gjymsë ore mësimi, d. m, th. për 23 minuta.

#### Tabella e mësimit.

shtëpin na e ndërton mjeshtëri.

muret bâhen me tulla, gurë e horasan.

çatën e mbulojmë me tjegullâ.

Ll. Kola '31.

## Provë-mësimi

### Dhanun në rendin e II<sup>të</sup> të shkollës Ushtrimore të Normales.

**Landa :** a) Vizatim parafytyrimesh  
b) \*Punë dore

**Thema :** a) Orendi shtëpiake  
b) Tryeza.


Mësimi u-fillua në lidhje me mësimin e përparshëm, q' i shte bërë për orenditë shtëpiake dyke iu thënë nxënësve të numëronin disa nga ato, që mbanin ment Nxënësve, pasi numëruan një shumicë prej tyre si: llambë, karrigë, tryezë, krevat etj, iu tha „ju me gojë dikë fare mirë t' i tregoni, po të shohim tani cili është ai, q' i mban ment më mirë se qysh janë ato.“ Për këte u-pyetë se ç' duhej bërë e si u-përgjegnë “ vizatim, „ u-ndanë radhonjt, u-urdhëruan nxënësit të nxjerrin lapsat e të vizatojnë çfarë të donin, prej orendive shtëpiake. Në kohën kur nxënësit vizatonin, mësonjësi u fliste për ta mbajtur trupin drejt e jo pranë bankës etj, edhe shkonte midis bankave, nixite nxënësit e ua drejtonte gabimet dyke iu thënë: “ Shih, shih si e paska bërë ky; a qëndron kariga pa këmbë, a rri tryeza shtrembër etj „ edhe jo “ e ke gabim këtu, “ ndreqe, etj. Kur u-pa se të gjithë nxënësit kishin bërë përgjithësisht nga një a dy a tri orendi, u-urdhëruan t' i futin lapsat brënda e t' i venë radhonjt në krye të bankës për t' u-mbledhur prej mësonjësit. Pas mbledhjes së radhonjvet, iu tha se një ndër orenditë shtëpiake, që shumica prej jush e ka bërë, është tryeza; këte pra ne tani do ta bëjmë edhe me letër punë doreje për ta pasur të bukur në radhua; prandaj nxirni radhonjt e letravet të punës së dorës edhe gërsnërët. Passi u-bë edhe kjo edhe si u-përfol tryeza prej mësonjësit bashkë me nxënësit në pjesët e 'sajë dyke u-filluar prej tokës, mbi të cilën qëndron tryeza, mbi këmbët e 'sajë, mbi pjesën, që lith këmbët, mbi pjesën e sipërme fare etj. atëhere, u-pyetën për ngjyrën e letrës, që do të tregonte tokën. Nxënësit dëftyen shumë farë, e më në fund, si u-zgjoth ajo m' e përshtatura, u-urdhëruan të presin prej 'sajë një rryp të gjatë sa letra vetë edhe të gjerë sa gishti. Ky rryp i prerë kështu u-la mbi bankë. Pastaj u tha mësonjësi nxënësve të gjejnë letrën, që do të tregojë tryezën.

Letra m' e mirë për 'të u-zgjodh në ngjyrë të kafesë, prandaj prenë edhe prej 'sajë një rryp sa ai i pari. Këte e prenë për gjysmë dhe njerën prej këtyre të dy gjysmëvet e prenë përsëri më dysh. Për këto dy të fundit u-pyetenë se përse na hyjnë në punë e, si thanë për këmbët e tryezës, i lanë mbi bankë afër atij rrypit të parë edhe gjysmën e parë të rrypit të dytë e vunë tok me rrypat e tjerë, se edhe ky do t'iu hynte në punë për të bashkuar këmbët e tryezës njerën me t'jetrën (kjo u-gjet prej nxënësve) U-pyetenë pastaj se a kishte gjë t'jetër tryeza a po mbaroi me kaqë e, si thanë ata "tani vjen pjesa e sipërme, iu tha të presin një rryp po prej asajë letre, të gjërë sa ai i pari e ta venë mbi bankë. Kur mbaroi edhe kjo u-pyetenë se ç' të metë i shihni tryezës edhe ata treguan se i mungonte dollapi a sirtari e për të bërë këtë iu tha të presin një copë të vogël e të rrumbullaktë. Kur u-mbaruan të gjitha këto, iu tha mësonjësi të futnin radhont e letravet brënda e të nxirnin ata të punës së dorës për të ngjitur pjesët e tryezës. Përpara se të fillonin t' i ngjitnin, mësonjësi u tha ta ndërtonin tryezën më parë mbi bankë. e, si e bënë këtë, atëhere nxënësit filluan t' i ngjitnin në radhua. ashtu si i kishin radhitur mbi bankë. Bashkë me nxënësit ngjitte edhe mësonjësi pjesët, që kishte prerë, në një letër të trashë të vënë në drasën e zezë, kështu t'iu shërbente si mostrë nxënësve, që kishin mbetur prapa. Kështu u-mbarua ora.

**Shënim:** 1) Kur prenë nxënësit rrypat e letrës së punës së dorës, preu edhe mësonjësi kundrejt 'tyre me dorën e mëngjert letrën, që mbante në dorën e djathtë.

2) Passi i prenë nxënësit rrypat u-urdhëruan t' i ngrënë përpjetë për t' i parë se kush e ka prerë, gjë që ndihmonte për të nxitur nxënësit të mos rrinë pas. Kështu u-bë edhe atëhere, kur u-ngjithë në radhua.

R. Hoxha '31.



## Provë-mësimi

Dhanun në rendin e III<sup>të</sup> të shkollës

Ushtrimore të Normales.

Landa : Gramatikë.

Thema : Zhvillimi i shkallëvet të mbiemnit.

Si hyrje në këte mësim u-nxuerr fjala ëmën prej nxânësve në këte mënyrë :

Mësuesi “ Si të quejnë ty ? Nxânësi mue më quejnë Pali „ — Ç’ farë më dëfteve ? “ Unë ju dëfteva ëmnin t’ em. „ — “ A vetëm ti ke ëmën ? — “ Jo Z. mësues, të gjithë njerzit kanë ëmna. „ — “ Po kafshët e bimët ? „ — “ Edhe kafshët e bimët kanë ëmna. „ — “ Ç’ farë na dëften pra ëmni ? „ Emni na dëften njeri, kafshë e bimë. Kjo fjali u-përsërit prej disa nxânësve e më në fund u-tha horas. Tani u-nxitën nxânësit qi të gjejnë disa ëmna njerëzish bimësh e kafshësh, si : Hasan, bankë, kal, Hatë, pulë, elb etj.

Mësuesi — “ Kush e din, a vetëm prej ëmnit i njofim njerzit na ? — “ Jo, Z. mësues, duhet t’iu dijmë edhe llagapin. „ — Po si i themi llagapit ndryshe ? “ Llagapit i themi mbiëmën. „ U-përçuen nxânësit qi të gjejnë disa mbiëmna të bashkuem me ëmën si : Petri i Math, Kija e vogël etj. Mësuesi — “ Cili është mbiëmni ndër këto fjalë ? „ — “ Fjalët i Math e i Vogël janë mbiëmna. — “ Pra cilës fjalë i themi mbiëmën ? „ — “ Fjalës qi dëften se si është ëmni i thomi mbiëmën. „ Edhe kjo fjali u-përsërit prej disa nxânësve e pastaj horas. Për të bërë ushtrimin e duhur, u-përçuen nxânësit qi të gjejnë disa mbiëmna të një-shëm e të panjfishëm si : i verdhë, e larme, i naltë, e dashtun, dinake, besnik, bardhush, qafzezë etj.

Mbas këtyne ushtrimeve u-zhvilluen shkallët e mbiemnit në këtë mënyrë : lu paraqit nxânësve një letër e gjatë nja 50 cm. dhe e gjanë nja 7 cm ; pastaj u-pyetën : — “ A është e gjanë apo e gjatë kjo letër ? Nxânësit „ kjo letër është e gjatë „ — “ Po fjalës e gjatë si i themi ? „ — “ Fjalës e gjatë i themi mbiëmën „ Fjala e gjatë u-shkrue më një anë të dërrasës së zezë e letra u-ngjit në drrasë të zezë ; pastaj u-muerr një letër t’jetër më e gjatë se e para e tue krahasue me të parën duet përgjegjja : „ Kjo letër është më e gjatë se ajo. Edhe fjala ma e gjatë u-shkrue në dërrasë të zezë nën fjalën e gjatë Fjalët,

e gjatë e mâ e gjatë u-përsëritën prej nxânësve. Letra u-ngjijt pranë së parës. Mâ në fund u-muerr letra e tretë, e cila ishte mâ e gjatë se e dyta. Edhe kjo u-krahasue me të dytën e u-nxuerr përgjegjja. Kjo letër është fare e gjatë. Mbassi u-shkrue fjala fare e gjatë nën të dytën dhe u ngjijt letra, u-kënduen të tri fjalët prej disa nxânësve e pastaj horas; e gjatë, mâ e gjatë e fare e gjatë.

Të tri letrat, qi u-ngjijtën në dërrasë të zezë, bájshin me fundin e 'tyne një vijë të drejtë e në anë të sipërme báheshin tri shkallë; sikurse shifet në pasqyrzën N<sub>o</sub> 1.

Mësuesi ( tue drejtue gishtin nga shkallët e letrave ) — " Kujt i ngjajnë këto ? „ — " Ato iu ngjajkan shkallëvet „ — " Mîrë, si duhet t' iu themi pra këtyne shkallëve ? „ — " Ne duhet t' iu themi atyne shkallët e mbiemname. Kjo fjalë u-përsërit si të tjerat prej disa nxânësve e pastaj horas, dhe u-shkrue në dërrasë të zezë.

Tani u-nxijtën nxânësit qi të gjejnë mbiemna të të tri shkallëvet si: i bukur, mâ i bukur e fare i bukur; e keqe, mâ e keqe e fare e keqe etj.

Me qenë se të tri letrat formojchin tri shkallë, duet edhe numri i shkallëve, vetëm u-shkrue mbi letrën e parë N<sub>o</sub> I, kështu edhe në të dytën e në të tretën.

Mësuesi — " Sa shkallë ka mbiemni ? „ — " Mbiemni ka tri shkallë: të parën, të dytën e të tretën „.

Mbas këtyne ushtrimeve i u-nxuerr përpara nxânësve një letër me ngjyrë të kuqe të hapët e, mbassi u-nxuerr përgjegjja " ajo letër është e kuqe „ u-nxuerr një t' jetër mâ e kuqe e, mâ në fund u-nxuerr e treta, e cila ishte fare e kuqe. Të trija këto letra u-ngjijtën në dërrasë të zezë. Nxânësit kënduen: " e kuqe, mâ e kuqe e fare e kuqe „. Pastaj u-udhëhoqën nxânësit qi t'i thonë në radhën e përkundërt mbiemnat, si: fare e thartë, mâ e thartë, e thartë; fare e butë, mâ e butë, e butë etj. Mbas këtyne ushtrimeve, për me i bā nxânësit qi t'i kuptojnë mbiemnat si pas shkallës së 'tyne u-pyetën: Mbiemni, fare i rrumbullakët, i cilës shkallë është? " Mbiemni fare i rrumbullakët është i shkallës së tretë. „ — " Po mbiemni mâ e ambël? „ " Mbiemni mâ e ambël është i shkallës së dytë. „ Në këtë mënyrë u-banë edhe ushtrime të tjera. Mâ në fund u-gjetën mbiemnat me shkallë si: Mësuesi gjeni një mbiemën të shkallës së III të; një të së I rës etj.

Për t' u- ngulitë sa më mirë mësimi, u- prishën të gjitha shkrimet, qi ishin shkruar në mësime sipër në dërrasë të zezë, edhe u- hoqën letrat. Tani filluen nxënësit me i thanë e me i gjetë mbiëmaat si pas radhës së shkallëve dhe anasjelltas.

**Pasqyrzat.**



I. Riza '31.

Për t' u- mendue.

**Të rijs dhe qytetnimi.**

Sot gjindemi në një periudhë, në të cilën po përpiqemi për me ia mërritë një t' ardhmeje të lumtun, një kohje të bukur plot me qetësi dhe me paqë. Thellojmë mendjen t' onë në fantazi plot me gëzime e me dëfrime. Mundohemi me i sjellun parafytyrimet e kalueme dhe me bënë një krahasim me ngjarjet e sotshme për me kuptue kohën t' onë t' ardhëshme. Zgjatim dorën andej, këndej, hedhim syt herë në qytetnimin e Perëndimit dhe herë n' atë të Lindjes për me shkëputë dishka prej 'tyne. Hedhim nga ndonji herë tejqyrën andej nga oqeanet e thellë dhe e këthejmë mandej nga hapsina pa fund për me pamun fenomenet e ndryshme. Hapim një nga një fjetet e historis, numërojmë fill e për pe veprat e ndonji poetit, të ndonji shkrintarit, të ndonji shpikësit, të ndonji dijetarit etj... dhe përsëri hidhemi në mendimin e thellë të jetës s' ardhëshme; zhysim mendjen t' onë për me i u- përgjegjun pyetjes : a duhet t' imitojmë ? man-

dej shkojmë më larg : Qytetnimit e Perëndimit a po qytetnimit e Lindjes të marrim si shembull ? .. Horvatem që të kënaqim pak vehten t' onë, por përsëri, të mërzitun nga gjykimi i gjatë dhe pa zgjidhun mirë punën, zgjohemi nga mendimi i thellë, hedhim syt rreth e përçark dhe drejtohem drejt një udhe pa mendue mirë se ku mund të na nxjerri.

Të rijs, shpresat e ardhëshme, imitojnë qytetnimit e Perëndimit dhe drejtohen me hapa të gjata për me ia mërrijtë atij.

Por qysh e imitojnë atë qytetnim ?

Kjo nuk është një pyetje e rëndë për me i u-përgjegjun njeriu, se puna duket vetë. Mjafton vetëm t' i vemë re me kujdes djaloshit :

Ai, për me imitue qytetnimit e Perëndimit, veshi pallton **bleu**, pantallonat **charleston**, kapellen **borsalino**, syzat e rrumbullakta dhe shkopin e trashë edhe ja na del përpara si një baron ! . . . “ Jemi — thotë — në shekullin e XX, mor zotni, duhet t' imitojmë Evropianët “ . . .

Po nana e ardhëshme, vasha e re, qysh vishet ? Ja edhe vajzat nuk duen të mbeten më mbrapa nga vëllazënit e 'tyne : Fustani i gjatë deri sipër gjunjëvet dhe pa mangë; me flokët e preme si djelm, me ecjen elegante dhe me dredhkat ( nazet ) e mëdha, që ka vasha e sotshme, do që të na thotë se i imiton Evropjankat. Ja pra edhe kjo na dëftohet si baroneshë.

Ati dhe nana e ardhëshme, tue u-veshun në këtë mënyrë, kujtojnë se kanë mërrijtë me të vërtetë në kulmin e qytetnimit. Harrojnë se nuk meritojmë të përdorim as fjalën “ qytetnim „ në qoftë se kujtojmë që jemi qytetnue, vetëm kur i fejuemi shkon krah për krah me të fejuemen; kur i riu vishet me robe të shtrëjta dhe e reja me kostume të kushtueshin e. Nuk mund të themi për një vashë se ka qytetnim, kur ajo qeth flokët, as për një djalosh, që mban vetëm bastun dhe syza. Nuk mund të themi se s' ka nevojë për diplomë shkollë një njeri, që di të këcejë **dance**, t' i bjeri pjanos, të vishet **luxe**, të zbukurohet mirë etj. Gjithashtu nuk mund të themi se e kupton qytetnimit një njeri, që ka shumë dredhka dhe politesë të tepërme. Asht shumë larg nga qytetnimit dhe ai njeri që, kur flet Shqip, për me u-tregue i ditun, përdor fjalë të hueja : **merci**, **bon jour**, **adio**, **soirée**, **disposition** etj., me gjithë që s' e di aspak atë gjuhë të huej.

Tue imitue pra në një mënyrë të tillë, d. m. th. tue imitue sypërfaqëshëm harrojmë nga ndonji herë se *c'kemi qenë*. Kështu, një djalosh i rritun në katund, në qoftë se mbaron së paku një shkollë plotore në qytet, ai mandej ka me pëlqye jetën e qytetit dhe s'ka me dashun as me e pa katundin e vet. Shum herë ngjan që po ai djalosh, përveç që nuk do me jetue në katund, por edhe ka turp të fjaloset me një mik katundar, që është veshë ndryshe. Po ky djalosh, që e quen vehten qytetar dhe që s'ka ndonji kulturë të naltë, ka turp me punue si bujk, nuk zen kazmë me dorë, nuk nderon katundarët e 'tij dhe përpiqet të fusi me një herë zakone të reja, që nuk i përshtaten aspak vendit. Me këte mënyrë ai fiton dy vese të këqij **përtesën** dhe **turpin për punë**. Harron ai se si ka qenë para katë, a pesë vjetve. Harron se ai për herë të parë ka veshun rrobe katundi dhe ndoshta ka hecun edhe zbathun. Harron, më në fund, se pa punë nuk jetohe.

Nga vinë të gjitha këto? Pa dyshim vinë nga ajo që s' dijmë si t' imitojmë, nga ajo që duem të bähemi si të qytetnuem, por tue marrë si shembull vetëm gjërat e fundit të qytetnimit: **veshjen** dhe jetën **luxe**. Harrojmë se rrobja nuk na sjell as një qytetnim; harrojmë se malli i vëndit e humbet fare vlerën, kur na do të pëlqejmë mallin e huej; harrojmë se lluksi i tepërtë sjell dhe krizën e madhe ekonomike, prandaj nuk duhet t' imitojmë në këtë mënyrë.

Ne s' kemi aspak nevojë për veshje **luxe**, se Shqiptarit kurdoherë i përshtatet një veshje e thjeshtë dhe e pastër. S' kemi nevojë as t' i marrim hua botës sjelljen e 'saj, se Shqiptari ka sjellje të mirë nga natyra: **nderi, besa** dhe **bujaria** e Shqiptarit janë me nam.

Ne të riht duhet të shkojmë me hapa të shpejta për me kapun punët dhe veprat me rëndësi të burravet me mend të botës mbarë. Duhet të përpiqemi t' imitojmë gjithmonë gjërat e vjeshme si bujqësin, industrinë, rregullimin e shkollave, letrësin, mjekësin, blegtorinë etj., se më tepër kemi nevojë për mjeshtëri të gjithfarëshme dhe për punë të dobishme, se sa për jetë llukse.

Hartime nxânësish.**Puno në riní, qi të jesh i lumtun  
në pleqni.**

Asht e ditun se njeriu qysh në fëmini është i pajisun me disa zotësi të natyrshëme, të cilat zhvillohen bashkë me jetën e 'tij. Nji nga këto është edhe puna, e cila ka nji rëndësi shumë të madhe për jetën e njeriut. Kjo lidhet aq pisk me jetën t' onë, sa qi mund të themi se jeta e njeriut s' është t' jetër veçse punë. Me të vertetë njeriu gjithëmonë punon, se vetëm me anë të punës do të mundet me sigurue jetën e 'tij e të familjes në kët botë. ndryshe, po nuk punoi, s' mund të rrojë ashtu si duhet.

Kjo e bân njerin, qi të mbâhet me gojë të mirë në shoq-nin njerzore. të nderohet prej të gjithve e të shijojë bukurit e ksaj bote. Të gjitha këto na tregojnë çiltas randsin e madhe, qi ka puna për ne. Pra, me qenë se kjo është udhëheqsja mâ besnike e jetës s' onë, duhet qi këte ta naltsojmë sa mâ tepër, qi kështu t' ia mbërrimë sa mâ mirë qëllimit t' onë.

Të gjitha përfundimet e mira, qi përmendëm sipër, mund t' i nxjerrim vetëm nga nji punë e bâme me rregull, me mend e në kohën e 'saj. Me të vërtetë, për me pasë përfundime të mira prej nji pune, duhet qi këte ta fillojmë në kohën e 'saj të volitshme. Koha pra, në të cilën duhet m' e fillue ate, është ajo e rinis, qi është si me thanë, prandvera e jetës. Me të vertetë njeriu ktu është në kulmin e fuqis së 'tij si në pikpamje mendore, ashtu dhe në pikpamje trupore. Në këte kohë ai është i zoti t' i vëjë në zbatim gjithë ato qi ka fitue qysh mâ parë në vogli, në shtëpi a në shkollë, sepse me anë të 'tyne, do t' i bájë ballë çdo vështirsije, qi mund të hasi në rrugën e jetës së 'tij.

Kjo është koha mâ e ambël e mâ e gëzueshme për njerin, pse në kët kohë ai shijon të gjitha bukurit e natyrës; këtë jetë e çon kaq të lumnueshme jo nga t' jetër, por pse është në gjendje të kryejë çdo punë, qi ia ka vù vehtes si barrë. Mirpo kjo është edhe koha, në të cilën njeriu ven bazat e kohës s' ardhshëme, të pleqnis, e cila me pak ndryshime i ngjan asaj të fëminis; kjo është koha mâ e vështirë e jetës së njeriut. Ktu njeriu nuk është mâ në gjendje të punojë me sigurue jetën e 'tij e të familjes. Me të vërtetë njeriu, deri sa është i ri, punon ashtu si duhet,

por mandej, si plaket, s' mund të bājë as mǎ të voglën punë. Prandaj pra, për këtë kohë kaqë të vështirë, duhet qi të punojmë qysh në rinis, qi kështu kur të plakemi, të mos e muadojmë trupin t' onë, por ta lǎjmë të qetë, mbassi këto janë ditët e fundit të jetës s' onë. Në kët kohë njeriu duhet t' ushqehet me pemët, q' i ka mbledhë në kohën e rinis.

Pra, për mos m' e mundue vehten në pleqni, duhet qi, deri sa jemi të ri, të punojmë edhe ca mǎ tepër se sa duhet e të prishim ca mǎ pak se sa fitojmë. Kështu do të mundemi me sigurue dhe lumnin e ardhshëm e s' do t' i trembemi aspak kohës s' ashpër të jetës, pleqnis. Për ndryshe, në qoftë se ne, deri sa jemi të ri, s' do të mendojmë aspak për kohën e ardhshëm, por do të punojmë vetëm sot për nesër. ahere në ditët e fundit të jetës, kur s' do të jemi mǎ të zotët me punue, do t' i bijmë kokës me grusht, por s' bǎn dobi se ǎsht vonë.

Prandaj pra kohën, deri sa të jemi të zotët m' e përdorë, s' duhet ta humbim kot, se kjo ǎsht ar për në e s' kthen mǎ. Këte s' duhet ta humbim kurrë ndër punë të kqija e pas dëfrimesh, të cilët nuk janë t' jetër, veçse vuejtjet e kohës s' ardhshëm, të pleqnis.

Nga të gjitha këto qi thamë, kuptohet se njeriu, për me sigurue lumnin e tij dhe në kohën e pleqnis, s' duhet ta çojë kohën e rinis kot e pa punë, por duhet të punojë e të kursejë, deri sa ǎsht i ri, se kështu do të rrojë i lumtun në pleqni e do të shijojë mundin e rinis.

D. Cara '31.

### Vjersha për shkolla.

## **Prendvera.**

I

Prendvera na hyri  
Mbinë manushaqet,  
Nga ç' do që sheh syri  
Zëmra jonë kënaqet.

III

Gjithë bagëtija  
Në livadh janë shtritur,  
Edhe njerëzija  
Dalin për t' shëtitur,

II

Fusha dhe lëndina  
Sot po gjelbërojnë,  
Dhe nga trendelina  
Pllajat po verdhojnë.

IV

Bujku shkon në ara  
Me qét të lëronjë,  
Bilbili si përpara,  
Zuri të këndonjë.

## I verbëri.

I

Verën që vjen mot  
Un' i mjeri s' e shoh dot,  
Kohën n' errësirë e shkonj  
I varfri un' si duronj.

II

Si të gjithë të shëkonja,  
Pa çdo gjë do ta duronja,  
Ah! kështu pra qënka thënë,  
Të mos shoh as djell' as hënë.

III

O njerës t' ju vinjë keq  
Për gjith këto që po heq,  
Pranë meje ju qëndroni  
Dhe pakëzë më ndihmoni.

H. Zhitë '32.

Novelë**Një dashuri që humb**

Ishim më 1910 Si nga hera kisha dalë për gjah dhe mbassi brodha nëpër brigjet e fushës së Gjirokastrës, që ndajnë këtë qytet nga fshatërat e 'sajë, ndënjta për t' u-çlodhur mbi bregun e kështjellës së Sh. Ndriallave, që thuhet se është ndërtuar prej Ali Pashë Tepelenës, për të luftuar me Gjirokastrën, e cila nuk i përulësh famës së 'tij Pamja piktoreske e fushës së Gjirokastrës të kënaqte syrin, pse të lashtat e mbjellura në këtë fushë, të përkëdhelura nga veriu, i përngjaniin valëve të detit në kohë të mirë.

I qetësuar nga çudia e kësaj pamjeje, pa pritur pashë përpara meje një vajzë dymbëdhjetë vjeçë, të bukur si pullumbeshë e të veshur me petkat e 'sajë blegëtoje. Vajza m' u-afrua me një tufë lule, qëndroi pak lark meje e më tha :

— I do ?

— Po vajzë, i dua ! e të falem nderit — i thashë dhe i përkëdhela mollëzat e faqes — Ti i mblodhe ?

— Po.

— Për cilin i mblodhe ?

— Për ty.

— Për mua ! më njeh mua ti ?

— Jo.

— E atëhere si t'erdhi në mëndje ?

Ungji syt duke tundur futën, këtheu kokën nga një ferrë aty afër e tha :

— Më tha ay.

U-këtheva e pashë fytyrën e gjallë të një djali, që dukesh midis gjembave. Vajzëza e thirri :

— Eja, dil, mos ki turp.

Djali u-afrua pranë nesh dalë nga dalë duke përtypur një fije bar.

— Ç' bëni këtu vetëm çapkënë ? iu thashë si me të qe-shur. — Veshtruan njeri t'jetrin në sy dhe djali tha :

— Po mbledhim lule.

— Ç' ju quajnë ? i pyeta.

— Mua më quajnë Vitori edhe këtë e quajnë Lele, tha vajza.

E thirra djalin të vinte edhe e pyeta në kishte aty afër nonjë burim me ujë.

— Si urdhëron, më tha — është një atje poshtë e sa e ka ujët të mirë !

— Merr-e këtë pagur dhe mbush-e — i thashë.

Lelja, i kënaqur nga besimi që i dhashë, vajt për ujë.

U-ulëm, si erdhi ay, e nisëm të fjalosemi. Pastaj ata filluan të këndojnë me zërin e tyre engjëllor. Më dëftuan me gisht urën e Drinit, që lith Gjirokastrën me fshatërat e 'sajë, më dëftuan Gjirokastrën, ku punonte i vëllai i Leles.

Para se të ndahesha nga ata, iu premtova se në Shtator do të këthehesha. Lelja më tha se dinte shumë vënde me thëllëza e do të m' i kallëzonte. Pas pak, kur ra kambana e fshatit, miqt' e mij të vegjël më lanë vetëm dhe vanë të mbledhin dhëntë, edhe unë nuk luajta nga vëndi, gjersa nuk dëgjova më të bërtiturat edhe fëshëllimat e 'tyre, që u flisnin dhënve.

“ Janë të kënaqur, të mjerët fëmijë „ — thoshnja me vehte duke veshtruar për të fundit herë Mingulin, fshatin e 'tyre. “ Janë të lumtur „ ! E, duke përsëritur këto fjalë, u-këtheva për në shtëpi dalë nga dalë me qenin t' im.



Premtimet e bëra i mbajta edhe e bëra zakon të vete për gjah nga ato anë, ku më tërhiqte sympathia për ata dy fëmijë

edhe pse kishte mjaft gjah. Kur më shquanin së largu më dilnin përpara. Lelja më dëftente vëndet, që kishin thëllëza; Vitoria, e kënaqur, më sillte nga një tufë me lule.

Vitëret shkuan shpejt, dhe ata u-bënë dy të rinj të hieshëm e të gjallë. Një gjë t'jetër, me kohë e kuptova. Fara e një dashurie, mbjellë e shvilluar n'ato vënde të qeta, kishte hedhur në syt' e 'tyre një ngjyrë melankolike. Këngët e 'tyre të kënaqëshme kishin pushuar. Kur veja, nuk më dilnin më përpara të gëzuar, e shumë herë i kisha gjetur që rrinin të qetë lark njëri jatrit.

— Vitori, ti ke rënë në dashuri! — i thashë një mbrëmje që deshte të më fshehte dëshpërimin e 'sajë për Lelen, i cili kishte mënuar të këthehej nga fshati. U-nkuq nga turpi dhe vajti të gjente një kec të humbur, që po blegërinte lark.

Një mëngjes, kur çlodhesha nën një pemë, Lelja m'u-ul pranë dhe duke marrë dorën t'ime në të 'tijt, që i dridheshin, më tha që e dashuronte Vitorinë e më pyeti në do të bënte mirë ta mirrte për grua.

— Në qoftë se munt t'u bësh ballë nevojave që ka një shtëpi — i thashë — marto-u, edhe do të bësh mirë, se Vitoria është një vajz' e mirë edhe të do. Familjet t' uaja a janë të kënaqura që të martoheni?

— Nuk janë të kënaqura, thaa? Shumë! vetëm prindërit e asaj më thanë që duhet të blejë edhe njëzet e pesë kokë dhën të tjera.

— Në qoftë se e keqja qëndron e tërë këtu — i thashë me nga dalë — i gjendet ilaçi.

Me këto fjalë Lelja m'u-duk sikur më dha një të përqa-fuar me sy. Heshti pak e pastaj tha:

— Është edhe një t'jatër pengim... Është shumë i math!

— Cili? — e pyeta.

— Unë jam në moshë të ushtërisë. Vitoria e di; por nuk e di që më ra llotua e që këto ditë do të më vijë urdhëri të nisem për Janinë e prej andej në Anadoll. Po ajo vajzë?!... Dëgjo se ç' bëri dje mbrëma: Më mori nga dora, e pa nxjerrë zë më shpuri në buzë të një honi dhe, duke më shikuar, nxorri një psherëtim. Po tashti? — i thashë. Ajo më tha. E sheh atë hon? Në qoftë se të marrin ushtar, kërko-më brënda n'atë hon, kur të këthehesh. Heshti e nuk tha gjë t'jetër.

Bisedimi i jonë u-pre nga zëri i Vitorisë, që thërriste :

— O Leleçe.

— Ç' do ?

— Shko në shtëpi se dikush të kërkon.

— Lelja u-largua me të shpejtë. e unë vajta te vajza. E gjeta që qante. Fillova ta pushonja, por nuk qe e mundur. I fola ca fjalë për t' i dhënë zëmër, por me se t' i jepnja zëmër ? E qërtova ëmbël : nuk më vuri veshin. I u-ula pranë dhe prita. Pakë nga pakë heshti e unë i vura nga dalë një dorë në krye, por përkëdhelja e ime nuk bëri gjë t' jatër veçse të shtonte të qarët e 'sajë.

— Po ç' ke, për Zotin, ç' ke ? Ti më njeh; ti e di gjithë miqësinë, që kam unë për ju të dy, se sa ju kam dashur...

— O Zot, o zot ! thirri ajo, ndihmona, ndihmona të biem ndër këmbë.

— Po ç' ngjau ? thuajmë.

— Do vejë ushtar, do vejë ushtar ! — Nuk tha gjë t' jatër. Mbeti atje si e fikët e po dridhej duke qarë. Nuk dija se ç' të bëja vetëm, pa nonjë shok, përveç qenit që kisha, i cili na hia dhej rreth e përqark i habitur duke lehur; kur dëgjova zën' e rojtësit të fshatit, Hasanit, e i thirra :

— Hasan, ç' ka ra Vitorisë. Eja shpejt këtu ose shko në shtëpi të 'sajë, që të vijë nonjë njeri ta marrë.

I ziu Hasan pa frymë erdhi tek ne. Me të parë vajzën n' atë gjendje, përshpëriti duke më vështruar në sy.

— O Zot i qiellit ! Ç' ka

— Pusho, pusho, — i u-përgjegjia — Le ta shpijem në shtëpi e atje e merr vesh se ç' ka. Eja : ti mbaj-e këtu poshtë.

Hasani kishte dëshirë të madhe të fliste, por unë nuk i bënja zë: kisha mendjen të vija këmbën me siguri, kur zbritmë rrugicat e kodrës. Kur arrijtëm në fshat, Lelja nuk ishte atje, se kishte vajtur — më thanë — në treg. Vitoria, pas pak minustave e mori vehten dhe dukesh e qetë; por unë desha që ta vinin në shtrat, se m' u-duk sikur kishte ethe.

U-këtheva ditën t' jetër e, për çudi, e gjeta Vitorinë, që rrinte te porta e shtëpisë; më përshëndeli me buzë në gaz. Më kallzoi se Lelja ishte thirrur ushtar e pas katër ditëve do të vente në Janinë, që të vishej e s' andejmi po shkonte në Izmir. Qetësia e 'sajë më çuditit tepër, por nuk u-dëftova. U-gëzova

me 'të q' e gjeta kështu të qetë dhe i thashë se Lelja i 'sajë do të çvishej shpejt e do të martoheshin; pastaj i thashë se e keqja, që vjen nuk dëmton e gjitha, pse që të dy qenë shumë të rinj akoma edhe një ndarje e shkurtër do ta shtonte dashurinë e 'tyre. Në të ngrysur, në kohë që do të ndaheshim, i thashë se për disa ditë nuk do të dilja për gjah, pse kisha punë.



Pas njëzet e pesë ditësh u nisua për në fshat dhe, duke vajtur, takova në rrugë rojtësin e fshatit, Hasanin.

— Udh' e mbarë Hasan.

— Mbarë paç. Ku do të veç ?

— Do vete në Mingul, te miqtë.

— Mos shko.

— Pse ?

— Dëgjomë mua, mos shko.

— Po pse, ç' është ? Ka ngjarë ndonjë gjë ? mos më mbaj në dyshim.

— Ki durim, na merr një cigar.

— Të lutem Hasan, thuajmë shpejt ç' ka ngjarë ?

— Djali u-vesh ushtar dhe u-nis. Atë ditë kur iku ky nga fshati, vajza nuk bëri gjë e as qajti, por filloi të mendohet dhe gjithë atë ditë nuk luajti nga praku i portës gjer në darkë duke u-fjalosur me vehte, pa kërkuar as bukë, as ujë, mëmës i bërtitte, kur kjo i lutesh që t' ikte andej, pse qe shkrirë në djersë nga dielli.

— Po fshati — i thashë duke i prerë fjalën — nuk bëri gjë ?

— Të gjitha u-bënë, por as gjë. I u-shkrua Valiut në Janinë që ta çvishnin Lelen, por ay u-përgjegj se nuk qe e mundur; i u-shkrua përsëri që ta lejojnë djalin të paktën edhe për pesë ditë, por nuk qe gjë. Më në fund telegrafuan në Stamboll edhe pas pesëmbëdhjetë ditësh erdhi djali gjysm' i vdekur, e unë për të parë përfundimin e takimit të 'tyre, desha ta shoqëroj vetë në shtëpi. Me të na parë vajza për së largu, nuk i luajti sytë nga ne; pastaj u-ngre me një heresh edhe vajti brënda në shtëpi për të dhënë, na u-duk neve, lajmin e ardhjes së Leles, po përkundrazi ajo dolli me të shpejtë me një sopatë në dorë e i u-vërsul Leles duke bërtituri " v r a n i - e v r a n i - e ! „; sikur të mos ishte atje dhe një gjendarm. i cili më ndihmoi ta

mbaja, do ta coptonte, pse ai mbeti në vënd si shkëmb pa u-shtëmëngur fare.

— U-marrua?! —

— Po si!

— Lemë të shkoj Hasan.

— Dëgjo, tashti s' ka . . . . .

— Mirë, mirë unë do të vete . . . . .

Pak më lark, u-poqa rrugës edhe me një fshatar dhe e pyeta për këtë punë.

— Çudi e madhe?! — më tha — nga ai nuk e besoja kurrë një gjë të tillë.

— Çë?

— Si, nuk e di që u-mbyt në lum Lelja?

— U-mbyt?! —

— Po. Iku mbrëmënet nga fshati për t' u-këthyer në . . . .

Nuk e lashë ta mbaronte fjalën, por u-nisa me të shpejtë i pikëlluar. Kur u-afrova te shtëpia e Vitorisë, doli nga porta mëma e 'sajë, e cila më priti me një mirsardhje si me gëzim e hidhrim. Pastaj ia dha të qarit e mjera grua dhe më dëftoi vajzën e 'sajë, që rrinte mb'anë të rrugës, edhe këndonte me një zë, që dukesh sikur vinte prej së largu. I u-afërova dhe i fola në ëmër, por ajo nuk luajti fare nga vëndi. I u-ula pranë; i mora kryet në duart e mija e fillova t' i them kështu:

— Vitori! e mjera Vito! jam unë. Nuk më njeh? Thuajmë ç' ke? të dhëmp këtu? — e i ngitja kryet. “Nuk e kujto të mjerin Lele? Ti e doje shumë! Të kam sjellë një parë vathë „.

Nuk u-tunt. I vura dorën nënjë mjekrë dhe i ngrita nga dalë fytyrën. Më vështroi dhe m' u-duk se diç do më thoshte dhe prita, por ajo më hodhi kryet e 'sajë në krahëruar.

I u-këtheva mëmës së 'sajë, që qante më nj' anë.

— Maro, e varfëra Maro! — i thashë.

— Ah zotni — më tha — shiko se në ç' gjëndje . . . .

V. Nasto '30.

Folklore-a**Kënga e Gjolekës. (1)**

Dërgon Gjolekë spanoi  
 Tafil Buzit të m' i thoi  
 Gjoleka s' e turpëroi  
 Nëpër dyzet mijë shkoj  
 Kaftanasit ia martoi  
 Me të dyja e qëlloi.  
 Një selam nga Smail Beu  
 Iu prish mëndja e dot s' ia ktheu  
 Iu poq firxhani për dheu

(1) Gjoleka e Tafil Buzi nga Kurveleshi, kanë qenë kryetarë të çetave shqipëtare, që janë ngritur, në kohë të para, kundra Turqisë. Kaftanasi ishte kumandant i ushtrive turke. Kur doli ky në Vlorë, vrau Ismail Beun, i cili ishte Shqiptar. Gjoleka me Tafil Buzin vendosën ta vrisnin Kaftanasin e në këtë mënyrë të mirresh gjaku i Ismail Beut.

Këtë punë e mori përsipër Gjoleka, i cili u-armatos mirë me dy kobure dhe me një dinakëri shkoj nëpër mes të dyzet mijë ashtarëve Turq edhe hyri në shtëpi, ku rrinte Kaftanasi, i cili, porsa ishte ngritë nga gjumi dhe rrinte me firxhan në dorë duke pirë kafe. Si mbas zakonit, Gjoleka i dha një selam prej Ismail Beut dhe e qëlloi me të dyja koburet. Atij iu prish mëndja edhe i ra firxhani prej dore në dhe, e kështu mbaroi jeta e tij.

Gjoleka i cili qubesh edhe spanua, se i kishte qimet të pakta në fytyrë, i dërgoi pastaj shokut të tij, Tafil Buzit, fjalët që ka kënga.

**Këngë dashurie**

Tatëpjetë bregut vije  
 Jelek verdha veshur,  
 Ashtu si kishë zakonë  
 Me llërë përveshur.

Thashë se vije tek unë  
 Dolla duke qeshur,  
 Ti veje tek keshe punë  
 Mbeta zëmëruar.

Djalë në të mbeti qejfi  
 Kthenem më të shkuar  
 Bota janë vrar' e prerë  
 Dhe janë pajtuar  
 Un' e ti as vrar' as prerë  
 Dy fjalë ndërruar

## Fjalë të vjetra.

Një e keqe nuk vjen kurrë vetëm.  
 Kush s' ka shoknë pyet shkognë.  
 Shokun mos e duaj, por pjesën ia ruaj.  
 Hankua po bën tertip,  
 mbëlith kashtë e mbëlith byk,  
 kali në Selenik.  
 Fjalë shumë e gur në trastë.  
 Shihmë turinë pa më verë tagjinë.  
 Mos u-gëzo i gëzuar, mos u-helmo i helmuar.  
 Dhëlpërës mishi s' i hahet, lëkura gëzof i mbahet.  
 Kal' i mirë e shton tagjinë.  
 Mos të qeshtë i qeshuri.  
 I vuari di sa i mësuari.  
 Dësh puna që në të parë, pa hëngër bisha gomarë.  
 Miku që kishe një herë, zuri mika miq të tjerë.  
 Fëmija pa nënë si nata pa hënë.

Mbledhur prej

M Ahmat' '31.

### Për t' u-çlodhur.

#### Në vapor.

— Shpejt ngreu! . . . . Vapor i po fundoset!  
 — Për se ma thua këtë gjë mua!? . . . Vapor i nuk është  
 i emi.

#### Teshat pa vleftë.

Vapori po mbytej. Kapidani i 'tij urdhëronte që udhëtarët të zbresin ndër barkat duke hedhur në det, gjithë ato që nuk' u duheshin. Një Zotni del bashkë me Zonjën e 'tij dyke mbajtur edhe dy valixha. — „ Ju thashë, thërret kapidani i inatosur, të hithni në det ato, që nuk ju duhen. „

— Dó t' ju bindem, tha Zotria, dhe me një herë e shtyri të shoqen në det !!!

#### A ke pesë lekë.

— Mundesh të më japç pesë lekë ?  
 — Më vjen shumë keq, së kam vetëm dy lekë me vete.  
 — Atëhere nem-i ata të dy : të tjerët m' i ke borxhë.

## Lajme të Shkollës

Më 22/1/1931 Shkolla Normale duel për të shëtitë edhe e hangrëm drekën në Manës. Koha që e mirë, u-nxuerrën fotografija edhe u-argëtuem shumë, por në mbramje u-këthyem si me nga dalë, se na u-desht me i çelun përsëri librat e shkreta për të nesërmen.

Më 17/1/1931 rendi '31 çfaq i n' internat dramën klasike "Besë" të Sami Frashërit. Po ky rend më 26/1/1931 këtë dramë e çfaq edhe në kinema-theatrën "Beethoven", për të mjeruemit e tërmetit të Korçës. Amatorët, më të pjekunit e shkollës Normale, kanë luejtun mirë. Shumë herë ndëgjuesit përplasën duerët. Me këtë dramë rendi '31 e pasqyroi me të vërtetë malsorin t'onë.

Më 31/1/1931 Normalisti Shëtitës '32 çfaq i n' internat dramën "I mjeri Djalë". Më 5/2/1931 po kjo çfaqje u-bà në kinema-theatrën "Beethoven". Të hollat e fitueme u-shtinë n' arkën e shoqënis. Shëfikaja luejti bukur; Zeqiu që i mirë, veç se i mungonte mjeshhtëria e të çfaqunit të dashunisë; edhe të tjerët mirë e bënë. Sqena që ndreqë për bukur.

Më 14/2/1931 rendi '33 çfaq i n' internat komedinë "Luloja" dhe më 6/3/1931 këtë çfaqje e bëni në kinema-theatrën "Beethoven". Të hollat u-përdorën për të përkohshëmen "Normalisti". Luki e ka teprue në shumë vënde. Luloja ka pasë pak naze. Guguçes i mungonin ca lëvizje. Guri dhe më fort Katoja kanë luejtun natyrshëm. Sqena që pa ndonji të metë. Të nesërmen kjo çfaqje u-bà edhe për nxënësit e shkollavet.

Më 20/2/1931 H. Zhiti '32 këndoi n' internat një vjerrshë satirike "Hoxha, Dervishi e Prifti", e cila na bëni që të shkulemi së qeshuni.

Më 15/3/1931 Internati luejti foot-ball me grupin e sportit të qytetit. Këtë lojë e fitoi internati 2:1. Shiu binte pa prà, por nxënësit shikojshin punën e në fund fituen. Mbas dy javësh internati u-ndesh përsëri në foot-ball me Elbasanin. Këtë herë qyteti duel më i zoti edhe e fitoi lojën 4:2.

Më 9/4/1931 Normalisti Shëtitës '32 çfaq në kinema-theatrën "Beethoven", komeditë "Pësime Mësime", dhe "Martesa me Pahir". Në "Pësimet Mësime", Trifuni ka tregue gjithë mjeshtrërin e 'tij. Dhoksapatriu fliste nga dalë dhe nuk ka pasë

lëvizjet që duheshin aty : ndoshta u-hutue nga hallva e tepërme, që hangri ! Mariana, dhe më fort Adriana kanë luejtun mirë. Ke " Martesa me Pahir ,, të gjithë kanë luejtun bukur, por më mirë Sganareli. Fitimi u-shti n' arkën e shoqënis.

Më 12/4/1931 u-bâ edhe një lojë t'jetër ndërmjet të Internatit edhe të qytetit; kësaj here nuk i mbeti hatëri as njanës palë, sepse puna duel 1:1.

Më 20 deri më 27 të Prillit u-bânë në shkollën t'onë provimet e Stazhit edhe ato t' Aftësis Pedagogjike. Në provimet e Stazhit fituen Z. Z. E. Koplku '26. S. Kutra '26, Z. Z. Hekali '27, D. Jakova '27, G. Keta '27. A. Myftiu '27, H. Ruhi '27. A. Kanakû '28, E. Tërshana '28, K. Vide '28.

Në ato t' Aftësisë Pedagogjike fituen Z. Z. Xh. Berberi. I. Gorishti, A. Ibrahim, S. Musai.

Më 28/4/1931, Normalisti Shëtitës '32, çfaqti në Kavajë komedit " Pësimet Mësimë ,, dhe " Martesa me Pahir ,, në sallën e Shkollës Mashkullore. Të hollat u-shtinë n'arkën e shoqënis. Atë kohë që ndejtën në Kavajë, ushqimin dhe fjetjen e kishin në Shkollën Shqiptare-Amerikane të Bujqësis. Normalisti Shëtitës '32 u falet nderit vëllazënvet të 'tij të shkollës së Bujqësis për këtë pritje kaqë të mirë. Bashkija e Elbasanit, Bashkija e Kavajës, Z. Fehmi Kazazi edhe Drejtorija e Shkollës Plotore Mashkullore u kanë ndifë shumë nxânësvet t' onë, të cilët u falen nderit me gjithë zemër.

Rrugës për në Kavajë kanë vuejtun mjaft nga ngushtica e vëndit t' automobil dhe nga shiu, që binte pa prâ. Në Kavajë ndejtën tri ditë dhe kanë pamë shumë vende, që kanë pasun një farë vlere. Ditën e fundit shkuen edhe panë Shkollën Shqiptare-Amerikane Femnore në mal të Robit; që andej panë edhe detin Adriatik, të cilin shumë nga nxânësit nuk e njihshin. N' Elbasan u-këthyen natën dhe rrugës kanë shkue me shumë qejf.

### Problemë.

Në majë të një kodre gjenden tri shtëpija; për kundrejt këtyne shtëpiave gjenden tre kroje. Duhet të shpijem ujë nga sejcili krue në sejcilën shtëpi. kështu që të tria shtëpitë të marrin ujë prej çdo kroi, në mënyrë që gypat ( sulinat ) e ujit të mos kryqëzohen udhës njani me t'jetrin. ( Kush e gjen merr një pajtim të Normalistit ).

S. Çano '32.

I: ...  
 II Vizat. parafektive: revoli shtetperike  
 Punë Dje : Trips  
 pramatë : Zhojllim rishkalve te mbledhur

## Posta e jonë.

**Z. M. Tafës, Lushnje.** Listën e pajtimtarëve edhe pajtimet për 3 vetë i muarrmë. Ju falemi nderit. Me postë ju dërguam edhe shtatë copë të Normalistit.

**Z. Z. Palit, Shkodër.** Do të bëjmë, si na këshilloni. Jemi në fillim, prandaj mos na i vini aqë re. Me postë ju dërguam (15) copë të së përkohshëmës. Ju falemi nderit për përkrahjen, q' i jepni Normalistit.

**Z. B. Zhudit, Pogradec.** Çudi me ju! Tri copët e së përkohshëmës, ju dërguam.

**Z. M. Golemit, Berat.** Kini qenë edhe vetë, i dini si janë punërat. Ju falemi nderit edhe presim kurdoherë këshilla. Atë që thoni, munt ta bëni ju me një mënyrë të pakuptuar. Ne s' kemi se ç' t' u bëjmë: janë të vrarë vetvetiu.

**Z. M. Musës, Kastriot.** Shtatë copët e së përkohshëmës ju dërguam me postë.

**Z. L. Mëshkallës, Orosh.** Numrat e këthyera i muarrmë si edhe pesë fr. ari, për të cilat ju falemi nderit shumë.

**Z. Xh. Xhafës, Delvinë.** Zgjidhja e pikturës historike nuk' është ashtu. Duam të dimë se cila është ajo ngjarje, që fshihet nën ngjyrën e kuqe.  
**Z. Z. A. Danit, Fier. B. Gjeçit, Kavajë. F. Ismatlit, Bilisht, R. Ramës, Himarë, R. Spahit, Homesh.** Listat i muarrmë, ju falemi nderit për përkrahjet edhe për fjalët e mira, q' i thoni Normalistit.

**Z. S. Çaçanit, Bilisht.** Normalisti ishte në shtyp, kur arrijti artikulli i juaj, prandaj u-la për numrin t' jetër. Dëshirojmë të bëjmë edhe të tjerët si ju.